



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KRYEMINISTRIA

MINISTËR SHTETI PËR PUSHTETIN VENDOR

AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E VETËQEVERISJES VENDORE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
MINISTËR SHTETI PËR PUSHTETIN VENDOR



PROCESVERBAL

MBLEDHJA E DYTË E KOMISIONIT TË VLERËSIMIT TË APLIKIMEVE (KVA) PËR GBP 2025

13 tetor 2025

Hapja e mbledhjes

Z.Sonil Frashëri, Këshilltar MSHPV në cilësinë e Kryetarit të Vlerësimit të Aplikimeve hapi mbledhjen e dytë të Komisionit të Vlerësimit për Grantin e Bazuar në Performancë. Në fjalën e tij hyrëse, ai falenderoi pjesëmarrësit për angazhimin e tyre dhe prezantoi përbërjen e komisionit si dhe pjesëmarrësit e pranishëm në këtë sesion. Më pas, ai paraqiti një përmbledhje të rezultateve paraprake të procesit të vlerësimit për treguesin që lidhet me **Planin Vendor të Menaxhimit të Mbetjeve**.

Në vijim të sesionit, znj.Olta Caca, Drejtoreshë e Drejtorisë së Statistikës dhe Performancës, paraqiti në mënyrë të strukturuar procedurën administrative që ndiqet sipas Udhëzimit të Përbashkët nr. 01, datë 11.07.2025, për shqyrtimin e aplikimeve të dorëzuara nga bashkitë. Ajo theksoi gjithashtu rolin dhe përgjegjësitë e sekretariatit teknik në këtë proces. Më tej, znj.Caca bëri një shpjegim të detajuar të të gjitha kriterëve që duhen përmbushur për Planin e Menaxhimit të Mbetjeve dhe vijoi me paraqitjen e rezultateve paraprake të verifikimeve mbi dokumentacionin e dorëzuar nga bashkitë.

KONKLUZIONET PARAPRAKE MBI KRITERIN E PLOTËSISË

- Totali i aplikimeve → **31 bashki**
- Dokumenti i Planit (brenda afatit) → **18 bashki**
- VKB (brenda afatit) → **18 bashki**
- VKQ (brenda afatit) → **10 bashki**
- Akti i konfirmimit të VKQ nga Prefekti → **10 bashki**
- Lidhja e publikimit të VKQ-së në faqen zyrtare → **9 bashki**

Bashkia	Dokumenti i Planit	VKB	VKQ	Akti i konfirmimit të VKQ	Publikimi VKQ	5 Kriteret
Dibër	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Divjakë	✓	✓	✗	✗	✗	✗
Dropull	✓	✓	✗	✗	✗	✗
Elbasan	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Finiq	✓	✗	✗	✗	✗	✗
Fushë-Arrëz	✓	✓	✗	✗	✗	✗
Gramsh	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Has	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Himarë	✓	✓	✓	✓	✗	✗
Kamëz	✓	✓	✗	✗	✗	✗
Kolonjë	✓	✓	✗	✗	✗	✗
Kukës	✓	✗	✗	✗	✗	✗
Librazhd	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Maliq	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Patos	✓	✓	✗	✗	✗	✗

Peqin	✓	✓	✗	✗	✗	✗
Prrrenjas	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Roskovec	✓	✓	✗	✗	✗	✗
Selenicë	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Tropojë	✓	✓	✓	✓	✓	✓

Pas prezantimit të rezultateve, *z.Frashëri – Kryetar Komisioni*, ngriti për diskutim çështjen që lidhet me kriterin e publikimit të linkut, duke propozuar që bashkive t'u jepet një afat për publikimin e planeve ose të vendimeve të Këshillit të Qarkut (VKQ). **Të gjithë anëtarët u dakortësuan.**

Znj.Erlisa Labi – Përgjegjëse e Statistikës – Sekretariati Teknik, solli për diskutim rastin e Bashkisë Himarë, e cila ishte e vetmja bashki që i plotësonte kriteret përveç publikimit të VKQ-së në web si dhe rast specifik ku akti i miratimit nga Prefekti ka **karakter individual**. Si rezultat, KVA vendosi që çështja e Bashkisë Himarë të mbetet për rishqyrtim të mëtejshëm.

Z.Frashëri vijon duke shpjeguar që për Planin e Menaxhimit të Mbetjeve, gjithësej kanë dorëzuar aplikim 31 bashki, me të paktën një dokumentacion. *Znj.Caca* parashtoi se **në përputhje me Udhëzimin e Përbashkët, Plani Vendor i Menaxhimit të Mbetjeve, i miratuar nga Këshilli Bashkiak përkatës, gjatë periudhës 1 janar – 17 shtator 2025, përbën kriterin themelor për konsiderimin e treguesit si të përmbushur.** Rrjedhimisht, janë pasqyruar për vlerësimin paraprak vetëm ato bashki të cilat disponojnë VKB-në për periudhën referuese.

Bashkitë: Dibër, Elbasan, Gramsh, Librazhd, Peqin, Përrenjas, Divjakë, Patos, Roskovec, Dropull, Kolonjë, Maliq, Tropojë, Fushë-Arrëz, Kamëz, Has, Himarë dhe Selenicë.

Z.Norbert Pjils– HELVETAS/BtF, vuri në dukje se qëllimi fillestar i dispozitës nuk ka qenë miratimi i VKQ-së, duke sqaruar se kjo është ndryshuar gjatë procesit dhe duke propozuar që çështja të rishikohet.

Duke u bashkuar me këtë qëndrim, *z.Erton Kashta– HELVETAS/BtF* theksoi se qëllimi i dispozitës nuk ka qenë që plani të miratohet nga Këshilli i Qarkut. Gjithashtu shtoi se publikimi i VKQ-së duhej të zëvendësohej me publikimin e VKB-së në faqen zyrtare të bashkisë dhe propozoi që ky element të merret në konsideratë në grantin pasardhës.

Lidhur me kriteret e cilësisë *z.Fran Brahimi– Drejtor i Drejtorisë së Financave Vendore*, propozoi që Ministria përkatëse të rishikojë kriteret e cilësisë dhe që këto të diskutohen më gjerësisht në mbledhjen e ardhshme.

Mbyllja e Mbledhjes

Z.Frashëri, në referencë të diskutimeve të mësipërme, sugjeron që të verifikohet nga ana e sekretariatit teknik vendimi i ri sa i takon **lidhjes së publikimit** dhe të dërgohen materialet e përditësuara me qëllim dakortësinë nga ana e anëtarëve të KVA-së. Gjithashtu njoftoi se **takimi i radhës** do të zhvillohet ditën e premte, në orën 10:00 ku do të merret dhe vendimi sa i takon

rastit të **bashkisë Himarë** dhe gjithashtu do të kemi një listë paraprake vlerësimi për kriteret e cilësisë që më pas të vijohet në daljen e një vendimi.

VERIFIKIMI SIPAS SUGJERIMEVE TË KVA-SË.

Sekretariati Teknik, ndoqi sugjerimet e KVA-së dhe më poshtë do të gjeni shqyrtimin e dokumentacionit për Planin e Menaxhimit të Mbetjeve nga Sekretariati Teknik – AMVV.

- Totali i aplikimeve → **31 bashki**
- Dokumenti i Planit (brenda afatit) → **18 bashki**
- VKB (brenda afatit) → **18 bashki**
- VKQ (brenda afatit) → **10 bashki**
- Akti i konfirmimit të VKQ nga Prefekti → **10 bashki**
- Lidhja e publikimit të VKQ-së në faqen zyrtare → **10 bashki**

Bashkia	Dokumenti i Planit	VKB	VKQ	Akti konfirmimit të VKQ	Publikimi VKQ	5 Kriteret
Dibër	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Divjakë	✓	✓	✗	✗	✗	✗
Dropull	✓	✓	✗	✗	✗	✗
Elbasan	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Finiq	✓	✗	✗	✗	✗	✗
Fushë-Arrëz	✓	✓	✗	✗	✗	✗
Gjirokastrë*	✗	✗	✗	✗	✗	✗
Gramsh	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Has	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Himarë**	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Kamëz	✓	✓	✗	✗	✗	✗
Kolonjë	✓	✓	✗	✗	✗	✗
Kuçovë*	✗	✗	✗	✗	✗	✗
Kukës	✓	✗	✗	✗	✗	✗
Librazhd	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Lushnje*	✗	✗	✗	✗	✗	✗
Malësi e Madhe*	✗	✗	✗	✗	✗	✗
Maliq	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Mat*	✗	✗	✗	✗	✗	✗
Memaliaj*	✗	✗	✗	✗	✗	✗
Mirëditë*	✗	✗	✗	✗	✗	✗
Patos	✓	✓	✗	✗	✗	✗
Peqin	✓	✓	✗	✗	✗	✗

Prenjas	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Poliçan*	✗	✗	✗	✗	✗	✗
Pustec*	✗	✗	✗	✗	✗	✗
Roskovec	✓	✓	✗	✗	✗	✗
Rrogzhinë*	✗	✗	✗	✗	✗	✗
Selenicë	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Shkodër*	✗	✗	✗	✗	✗	✗
Tropojë	✓	✓	✓	✓	✓	✓

*Këto bashki rezultojnë me Vendimin e Këshillit Bashkiak jashtë afatit të përcaktuar, sipas Udhëzimit të Përbashkët Nr.01, datë 11.07.2025.

**Bashkia Himarë është rast specifik e cila ka shprehjen e ligjshmërisë nga Prefekti të vlerësuar se akti ka karakter individual dhe plani i dërguar i referohet “Studimit të kostove të shërbimit për menaxhimin e integruar të mbetjeve”.

Anëtarë e Vlerësimit të Komisionit të Aplikimeve

Lista e anëtarëve të KVA				
Treguesi: Plani vendor i Menaxhimit të Mbetjeve				
Nr.	Institucioni	Emër	Mbiemër	Pozicioni në KVA
1	MSHPV	Sonil	Frashëri	Kyetar
2	SHKBSh	Adelina	Farrici	Anëtar
3	MF	Fran	Brahimi	Anëtar
4	MTM/ AKEM	Dhimitraq	Prishka	Anëtar
5	MTM	Blerta	Çali	Anëtar